Nuk e dij me cilën grue i ka, por e dij se ka pesë fëmijë: dy çuna e një gocë. Grueja e parë u-mbyt në liqê, gjashtë vjetë më parë.

Unë s'kam qenë aty, por thonë se ai e ka shtý. Zoti e di !

Ai pinte dhe gjithënji pi shumë. Shkon vonë në shtëpi dhe pret t'a gjejë gruen çue dhe po të ketë shkue me fjetë fillon t'a shajë e t'a rrafi.

Fqijt e tyne më kanë thënë ç'ju thash më parë. Që ai pi, atë e di gjithëkush.

Po, më ka 1238 lekë borxh. I a kam kërkue sa e sa herë, por më kot.

Eh, mor Zotni, sikur t'a dijshi sa njerëz më kanë borxh, kishi për t'u-çuditë. Nuk kam kohë të padis botën.

Urdhënoni kur të doni. Tungja-tjeta !

If I want to send a message to Dibra, what should I do ?

Po të duesh me dërgue ndonji lajm në Dibër duhet të merremi vesh me kryetarin e rezistencës n'Elbasan. Ai njerë shumë njerëz besnikë që venë e vijën nga Dibra.

Is there any danger that it might be intercepted on the way by the enemy ?

Nuk besoj të kapet rrugës, mbassi tue qenë fshatár nuk bje shumë në sý. Me gjithë atë mund të ngjajë dhe e kundërta.

What's the quickest means ?

Mjeti má i shpejtë, por má i rrezikshëm, do t'ishte tue udhëtue me autobus nga Elbasani në Peshkopí. Má i sigurti, por natyrisht má i ngadalshmi, ást me shkue më kambë.

Which is the way that should be followed ?

Kjo rrugë bje nga malet e Çermnikës prej nga zbritet drejt në Peshkopí.

How can I get in touch with the leader of the underground in Elbasan ?

Po të duesh me rá në kontakt me të mund t'a rregulloj unë, mbassi kushrinin e tij e kam mik.

Whose son is he ?

Më vjen keq por nuk mund të të thom as si quhet as se i biri i kujt ást.

From whom do you get all this information ?

As unë nuk e dij se si i marr vesh !

How do they communicate the information to you ?

Nuk ást nji punë shumë e vështirë. Kemi mënyrë të sigurta se si me u komunikue antarëvet lajmet e informatat e nevojëshme.

So you are sure that if I go to Elbasan to meet the underground leader I won't fall in some trap.

Mos u-bân marak ! Më lajmo 24 orë para se të nisesh kështu që të lajmoj Elbasanin për mrritjen tände.

In that case I'll leave tomorrow afternoon.

Shumë mirë. Të qoftë udha e mbarë !

Hello !

Is Lieutenant Kodra there ?

I'm Captain Dhori.

Yes, it's me, Lieutenant. How is the weather over there ?

Here we are having wonderful weather. Listen please, Lieutenant ! You had better take notes ! Do you have paper and pencil there ?

About 5 kilometers from where your unit is located the enemy has begun to open trenches.

Yes, there is even more ! We know that the 96th and 169th divisions have left in that direction.

You will send four or five men disguised as villagers who will try to get informed about this matter.

They should remain there until we call them back. They should send the information with trustworthy people as often as they see it feasible !

Notify at once the Division HQ's so that they will take care of that.

As soon as you hear any news from them call me up.

Yes, I almost forgot ! Tell the informers to find out also if the 28th Armor Division is still in Shajë, OK ?

Hallo !

Po, këtu është. Kush jeni ju lutem ?

Hallo, Kapiten Dhori ? Si jeni Zotni Kapiten ?

S'ka mâ keq. Ka vetue e bumbullue gjithë natën e tash është tue ra shi.

Po, kam. Urdhënoni, jam gati.

Vërtetë ?

Qka doni të bâj ?

Si urdhënoni.

Mirë, por për kët gjâ ka me na u-dashë me pasë shumë të holla. Këtu kemi aqë sa me jetue. A mund të na dërgoni sa mâ parë nja 2000 a 3000 lekë ?

Posa të mbarojmë së foluni do të nis një lajmtâr për në Komandën e Divizionit...

Si urdhënoni, Zotni Kapiten. Ka ndonji gjâ tjetër ?

Pa tjetër, Zotni Kapiten. Besoj të ju thërras përsëri mbasnesër mbasdreke. Tungjatjeta.

What's your name ?

Më quejnë Bashkim Gjata.

When and where were you born ?

Kam lé në Muzhaq t'Elbasanit me 17 Maj 1921.

What kind of a school system did you have before the communists took over ?

Kishin sistemin shkolluer francez e sviceran, me fjalë tjera sistemin european.

If I remember correctly you used to have two years of preparatory school, five years of elementary and eight years of secondary school !

Po, ashtu është, Zotni. Shkolla e mesme ndahesh në katër vjetë gjimnaz e katër vjetë licé ase në pesë gjimnaz e tre licé.

Did you have any other kind of secondary schools besides the ones you mentioned ?

Po, kishim shkolla normale, teknike, bujqore, tregtare e ushtarake.

Where did the Albanian girls and boys go for higher studies before the State University was established ?

Përjashta. Zakonisht n'universitetet e Italis, t'Austris e të Francës. Kemi pasë studenta që shkojshin me studjue edhe në Gjermani, në Belgjikë, n'Angli, në Shtetet e Bashkueme e gjetiu.

What about now, what kind of a school system do they have ?

Tash kanë sistemin e shkollavet ruse. Katër vjetë fillore ase shkollat shtatvjeçare, katër vjetë gjimnaz dhe universitetin. Ka gjithashtu edhe disa institute të nalta.

Isn't there any other kind of secondary school besides the gymnasia ?

Po, natyrisht, ka edhe shkolla industriale, teknike, bujqore (teknikume), ushtarake etj., pak a shumë si të mëparëshmet.

Do all the students that go to the university now attend the State University ?

Jo, një numër i madh shkojnë edhe ndër universitetet e Rusis e të Republikavet Popullore.

When is a student able to enroll in a polytechnical (teknikum) school and when in one of the high institutes ?

Një nxënës mund të hýjë në një nga teknikumet mbassi të mbarojë shkollën shtatvjeçare dhe në një nga institutet e nalta mbassi të kryejë gjimnazin.

Thank you very much, Mr. Gjata.

S'ka përse.

What's the number of your ID card and what's your rank ?

Jam rreshter dhe numri i letërnjoftimit është mbi të. Tetari aty e ka letërnjoftimin tem.

What unit did you belong to ?

Jam në Batalionin e 2të të Regjimentit të 5të të Divizionit të 17të të Mekanizuem.

What were you doing near our lines when we captured you ?

Kishem urdhën me vendosë mina antitanks e mina kundër njerëzve 300 m. para fortifikatavet tueja.

Who was the group leader ?

Unë ishem.

How many men did you command ?

Grupi përbâhesh prej 12 vetësh.

What was the reason you were ordered to place mines in front of our positions ?

Nuk e di arsyen; mue më dhânë urdhën me e bâ këtë gjâ dhe askush nuk më tregoi arsyen.

When did the 17th Mechanized Division come to this sector of the front ?

Nji pjesë ka ardhë nja tri javë më parë, pjesa tjetër ndodhet në këtë zonë të frontit tash 10 ditë...

When did you come ?

Regjimenti i 5të ka ardhë me grupin e dytë 10 ditë më parë.

What sector of the front did your Regiment come from ?

Regjimenti i 5të, i 7të e i 8të nuk ishin në front. Na kemi qenë caktue me detyrë ndër mbrapavija.

What did you do in the rear lines ?

Ndihmojshim Divizionin e 14të të Xhenjos në ndreqjen e rrugëvet, t'uravet etj.

For how long did these three regiments work with the 14th Engineer Division ?

Kemi qenë tue punue n'at sektor të mbrapavijavet për nja 9 javë.

What division did you come to replace in the front ?

Nuk e di. Si ju thash, kur erdha unë gjeta në front njësit e divizionit tonë që kishin ardhë dy javë para nesh.

Where is your Battalion HQ's located ?

Komanda e Batalionit gjindet në një çadër pranë lumit.



Is there any building in this city which we can use for offices and for classrooms ?

Where is this building located ?

Does the bus go anywhere near there ?

Is it a wooden building or of some other material ?

How many floors does it have ?

For what purpose has the building been used before ?

Does the building have any suitable room for the showing of educational films ?

Where can we find the owner of the building ?

What do we do then ?

How much rent do you think he will ask for it ?

Is it possible to rent it for a short period of time ?

Shall we go and speak with the Major's lawyer ?

Po di një godinë që ka një njizet e sa dhoma dhe nuk besoj të jetë e zânun.

Gjindet në skaj të qytetit.

Po, autobusi ndalet pothuajë tridhetë hapa larg nga godina në Rrugën Mihal Grameno.

Godina është prej betoni dhe është ndërtuar katër vjetë më parë.

Ka tri kate dhe podrum.

Gjatë luftës qeverija e ka përdorur si shkollë nate për punëtorët e mprojtjes.

Po, ka një dhomë që mund të zëjë një 50 vetë dhe mund të përdoret për at qëllim.

Pronari i godinës është një major në pension por banon jashtë qytetit.

Pronari përfaqësohet prej Zotni Avokat Drenovës. Mund të shkojmë e të flasim me avokatin.

Besoj se qiraja do të jetë rreth 15,000-17,000 lekë në muaj.

Besoj se do të pranohet vetëm një kontratë tre vjetësh.

Asht një mendim shumë i mirë; ai do të na api spjegime më t'imita se ato që ju dhash unë.

Take that chair and sit down, Sergeant. When did you find out that your Battle Group was about to leave the front ?

Do you know what unit will come to replace yours ?

How far back is the new line of resistance going to be ?

How many casualties did you have in your Battle Group during the offensive we launched last week ?

What were you supposed to do with all the ammunition and the other material that you had ?

Who was to cover your retreat to the new line of resistance, the heavy artillery and the rocket launchers ?

Then your retreat will be covered by tactical air support !

Did your Tactical Air get any new type of airplanes ?

Where did you hear this news ?

Dý ditë më parë Komandanti i Kompanisë na lajmoi se së shpejti Grupi ynë i Luftimit do të largohesh nga fronti për t'u-rrior-ganizue e për të pushue.

Me sa kam ndigjue ky sektor i frontit do të lëshohet prandej nuk do të vijë njeri me na zâvendësue.

Nuk e di, por ndoshta do të tërhiqen nja 10-12 km. deri ke vargu i kodravet.

Kompanija jonë ka pasë 30% humbje dhe mbetëm vetëm me një oficer. Nuk di gjâ mbi kompanit tjera por mendoj se edhe ata do të kenë pasë humbje të rânda.

Çdo automjet e çdo tanks në gjendje të mirë do të tërhiqesh me trupat; tjerët do të shkatrroeshin. Teprica e municionit që nuk do të mund të transportohesh do të hudhesh n'erë.

Mos harroni se Aviacioni ynë Taktik është në gjendje me e djegë e me e shkatrrue kët zonë.

Këtë nuk e di por di se Aviacioni Taktik është tue pritë me padurim tash dý javë që të hapi pak koha.

Po. Disa njisi t'Aviacionit Taktik janë pajisë me aeroplana të rij reaktivë luftues-bombardues që shkojnë pothuaj dý herë më shpejt se shpejtësija e zânit.

Komandanti i Batalionit po u tregonte disa oficerave tjerë, trí ditë më parë, çka ju thash. Unë kalova rastësisht andej dhe e ndigjova.

Tell me Sergeant, how is the climate in Albania, generally speaking ?

What about the rest of the country, how is the climate over there ?

This climate goes for the highlands too, I guess !

What kind of roads do you have in Albania ?

It will be easy then to visit any region of the country. Are there many beautiful spots ?

There must be quite some places for a person to spend a vacation in some summer resort !

Are there hotels and restaurants, let's say in some climatic center in the mountains of Northern Albania ?

Which is the most famous beach in Albania ?

How far is the beach of Durrës from Tirana ?

Klima ndër krahina bregdetare është përgjithësisht e butë. Gjatë bregdetit pothuaj kurr s'bje borë.

Ndër krahinat që janë pak larg nga bregdeti gjatë dimnit bje borë e ngrin akull kurse vera është zakonisht e nxehët.

Pak a shumë, por ndër zonat malore vera nuk është aq e nxehët kurse në dimën bje kaq shumë borë sa shpesh qëllon të zehen rrugët.

Kemi një rrjetë rrugësh mjaft të mira. Këto rrugë lidhin të gjitha krahinat e Shqipërisë me njëra tjetrën.

Ka male të bukura që janë të mbulueme me borë dimën e verë. Ka liqëj, lumenj e pyje madhështore. Një nga këta liqëjt (ai i Pogradecit) është i famëshëm për këthjelltësinë e ujit të tij.

Ka vende verimi e vende klimatike në të gjitha anët e Shqipërisë, në Veri e në Jug e gjatë gjithë bregdetit.

Po, ka hotele ku mund të merrni një dhomë me qirë dhe restoranta ku mund të hani me çmime t'arsyeshme.

Plazha e Durrsit është më e famëshmja qoftë sepse ka shumë hotele, restoranta e vende dëfrimi por edhe sepse këtu shkojnë me mija njerëzish nga Tirana për të verue e për pushime.

Asht fare afër, 39 km. nga Tirana.

What's your name, rank and ID card number ?

Më quejnë Thoma Seresi dhe jam ushtár i thjeshtë. Numri i letërnjoftimit është 794-256.

What unit did you belong to ?

Ishem në Kompanin e 5të të Brigadës së 3të të Korparmatës së 6të.

What were your duties in the 5th Company ?

Ishem në Seksionin e Mirëmbajtjes së Mjetëve të Motorizueme. U-kujdesojshim që tanksat, topat vetlëvizës, kamionat etj. t'ishin në gjendje të mirë.

What type of tanks did you mostly work on ?

Në Korparmatën e 6të kishte vetëm tanksa të mesëm dhe një brigadë topash vetlëvizës.

What kind of armament do your medium tanks have ?

Kanë nga një top 90 mm., nga një mitraloz 30 mm. e nga një mitraloz 50 mm.

What's the effective range of the 90 mm. gun that is placed on the tank ?

Nuk e di me siguri por kur topi është i pajisun me shinjës-tër me teleskop besoj se ka një rreze të përpikët prej 2600-2800 metrash.

What kinds of SP guns are there in the 6th Army Corps ?

Unë kam pá vetëm dy lloj topash: topin vetlëvizës 100 mm. dhe topin vetlëvizës 155 mm.

How many companies were there in your brigade ?

Brigada e 5të përbâhesh prej pesë kompanish dhe prej dy togash: një togë sinjalesh dhe një togë në rezervë.

What kinds of weapons had the various companies ?

Kompanija e 1rë dhe e 2të përbâheshin prej pushkatarësh, Kompanija e 3të ishte e pajisun me mortaja 81 mm. dhe Kompanija e 4të me armë antitanks.

What about the 5th Company ?

Një pjesë e Kompanis së 5të ishte caktue, si ju thash, me Seksionin e Mirëmbajtjes së Automjetëve, pjesa tjetër ja ishte në rezervë ja ndihmonte Kompanin e 3të të Mortajavet.

Questions on Military Subjects  
Pyetje me karakter ushtarak

- 1.- Thoni emnat e gradavet të nënoficeravet t'ushtrís shqiptare.
- 2.- Thoni emnat e gradavet t'oficeravet t'ushtrís shqiptare.
- 3.- Sa kompaní ka zakonisht një batalion ?
- 4.- Ç'gradë ka komandanti i një divizioni ?
- 5.- Në cilën kompaní jeni ju ?
- 6.- Cila gradë vjen mbas majorit ?
- 7.- Si quhet njisisja që është më e madhe se skuadra ?
- 8.- Kush jeton në një kamp ushtarak ?
- 9.- A keni hyë në ushtrí si vullnetár apo si rekrut ?
- 10.- Si quhen ndërtesat ku flëjnë ushtarët ?
- 11.- Ç'gradë keni ?
- 12.- A keni shti ndonjiherë me mitraloz ?
- 13.- A kemi këtu ndonji nxânës që bân pjesë në Aviacion ?
- 14.- Çfarë pushke kanë ushtarët e ushtrís shqiptare ?
- 15.- A bân pjesë në Artilerí ?
- 16.- Cila degë e ushtrís ka më shumë topa ?
- 17.- Cila është grada më e naltë e një nënoficeri t'ushtrís shqiptare ?
- 18.- Ç'detyrë ka një rojë ?
- 19.- A ka zyrë rekrutimi në Monterey ?
- 20.- A kemi në këtë klasë ndonji nxânës që bân pjesë në Marinë ?
- 21.- Ç'gradë ka komandanti i shkollës sonë ?

- 22.- Cila është grada më e ultë në ushtrinë shqiptare ?
- 23.- Ç'd.m.th. shqip "enemy soldiers" ?
- 24.- Ku e ka qendrën Divizioni i 5të ?
- 25.- Cila është njësia më e vogël e ushtrisë ?
- 26.- Thoni gradat e oficerave eprorë.
- 27.- A kemi ndonjë oficer në këtë klasë ?
- 28.- Sa komandanta ka çdo togë ?
- 29.- Çfarë njësie komandon një major ?
- 30.- Çka i zgjon ushtarët në mëngjes ?
- 31.- Sa kompani ushtarësh ka në Presidio ?
- 32.- A keni udhëtuar ndonjëherë me aeroplan ?
- 33.- A ka në Presidio ndonjë armë antiajrore ?
- 34.- Thoni emrin e ndonjë arme antitanks.
- 35.- A keni shtirë ndonjëherë me revolver automatik ?
- 36.- Çfarë ngjyre ka kapela e ushtarëve të Aviacionit ?
- 37.- Sa larg mund t'a hudhni një bombë dore ?
- 38.- Sa fishekë zë një çiftë ?
- 39.- Sa peshon një predhë për topa antitanks ?
- 40.- Çfarë armësh përdorin ushtarët e kambësoris ?
- 41.- Kur keni qenë në manevra herën e fundit ?
- 42.- A ka oficera të Marinës në këtë shkollë ?
- 43.- A përdorjnë mina ushtarët e kambësoris ?
- 44.- Sa larg mund t'a hudhi predhën një mortajë ?
- 45.- Ku e ka qendrën shtabi i Divizionit të 12të ?

- 46.- Zakonisht, sa topa ka një tank ?
- 47.- Sa nalt mund të shkojë një aeroplan ?
- 48.- Thoni emrat e armëve që dini ?
- 49.- Thoni emrat e degëve të ndryshme të Fuqive të Armatosuna.
- 50.- Sa aeroplana besoni se ka Aviacioni i Shteteve të Bashkueme ?
- 51.- Ç'gradë do të keni kur të dilni nga ushtria ?
- 52.- Sa peshon një bombë dore ?
- 53.- Sa ushtarë flëjnë në një kazermë në Presidio ?
- 54.- Ç'gradë vjen përpara kapitenit të klasës së parë ?
- 55.- Sa fishekë mund të zbrazi në minut një mitraloz i lehtë ?
- 56.- Çfarë njisisje komandon një nënoficer ?
- 57.- Sa vjetë duhet të rrijë në ushtri një rekrut ?
- 58.- Krye sa orësh ndërrohet një rojë, zakonisht ?
- 59.- Cilat degë të Fuqive të Armatosuna kanë shtabe ?
- 60.- Sa vjetë do të rri në rezervë mbassi të dilni në lirim ?
- 61.- Sa mitraloza ka një tank i lehtë ?
- 62.- Kur do të gradoheni ?
- 63.- Cila është grada më e ulët e oficerave të ushtrisë shqiptare ?
- 64.- A kanë më ushtri njisi kalori ?
- 65.- Çfarë plaçkash mbahen në një magazinë ?
- 66.- Sa fishekë zë një revolver automatik ?
- 67.- A ka armë antiajrore automatike ?
- 68.- Sa kilometra në orë mund të shkojë një tank ?
- 69.- Thoni emrat e disa armëve automatike.

- 70.- Sa vjetë shërbim i duhen një togeri me u-gradue kapiten ?
- 71.- Sa mund të peshojë një bombë aeroplani ?
- 72.- Ç'gradë ka komandanti i Fort Ord-it ?
- 73.- Sa nënoficera ka një togë ?
- 74.- Sa mitraloza ka një togë kambësoriye ?
- 75.- Sa lloj kapitenash ka ushtria shqiptare ?
- 76.- Me se merren ushtarët e Intendencës ?
- 77.- Ku flëjnë trupat kur shkojnë për fushim ?
- 78.- Sa bomba dore ka një ushtár që është gati për sulm ?
- 79.- Në rasë luftime cilët merren ushtarë ?
- 80.- Sa njerëz zë një tanks ?
- 81.- A dini me i rá burís ?
- 82.- Ku gjindet qendra e rekrutimit të gadishullit të Monterey-t ?
- 83.- Kush është komandanti i përgjithëshëm i Fuqivet t'Armatosuna të Shtetevet të Bashkueme t'Amerikës ?
- 84.- Sa kazerma ka në Presidio ?
- 85.- Cili shtje më larg: një top apo një mitraloz antiajruer ?
- 86.- Sa fishekë zë një pushkë M-1 ?
- 87.- Cila është dega më e madhe e ushtrís ?
- 88.- Sa skuadra ka zakonisht një togë ?
- 89.- Cila është grada më e ulët e ushtrís shqiptare ?
- 90.- Ç'gradë ka kryetari i një skuadre ?
- 91.- Cila është dega më e madhe e Fuqivet t'Armatosuna ?
- 92.- Sa peshon, afërsisht, një mitraloz i rëndë ?



- 93.- Sa magazina ka në Presidio ?
- 94.- A ka ndonji shkollë të Marinës në Monterey ?
- 95.- Çfarë çizmësh kanë pjesëtarët e Fuqivet t'Armatosuna të Shqipnis ?
- 96.- Sa bataliona ka zakonisht një regjiment ?
- 97.- Cila gradë vjen mbas kapterit ?
- 98.- Sa brigada ka zakonisht një divizion ?
- 99.- Sa divizione ka zakonisht një korparmatë ?
- 100.- Sa mitraloza ka një aeroplan luftues-bombardues ?
- 101.- A ka ushtria shqiptare njësi kalorije ?
- 102.- Sa milë (kilometra) mund t'eci një ushtár në 24 orë ?
- 103.- A mund të gradohet një nënoficer e të bëhet oficer ?
- 104.- Për sa muaj rri një aspirant me at gradë ?
- 105.- Prej sa vetësh përbëhet zakonisht një patrullë ?
- 106.- Sa lloj tanksash ka ushtria shqiptare ?
- 107.- Çfarë armësh përdorin ushtarët në sulm ?
- 108.- Sa njerëz duhen për të baltë një mortajë ?
- 109.- Ku vëhen minat, zakonisht ?
- 110.- A bëjnë shpesh manevra në Fort Ord ?
- 111.- Me çfarë armësh janë të pajisun ushtarët e Artileris ?
- 112.- Sa larg e hudh predhën një top antitanks ?
- 113.- Sa fishekë ka me vete një ushtár, zakonisht ?
- 114.- A ka aeroplana t'armatosun me topa automatikë ?
- 115.- Çfarë arme bëjnë me vete policët ?
- 116.- A keni baltë ndonjiherë rojë natën ?

- 117.- Cila degë e ushtrisë është më e madhe: kambësoria apo xhenjoja ?
- 118.- Sa është i gjatë një top antitanks ?
- 119.- Si quhet njësia më e madhe e ushtrisë ?
- 120.- Çfarë armësh përdoron artileria ?
- 121.- Prej sa korparmatash përbëhet zakonisht një armatë ?
- 122.- Sa nënofficera ka një batalion ?
- 123.- A ka në qytet ndonjë magazinë ushtarake ?
- 124.- A veshin çizme pjesëtarët e Fuqivet t'Armatosuna të Sh.B.A. ?
- 125.- Me çfarë vegle mund t'orientohet një ushtár ?
- 126.- Kur filloi lufta e dytë botënore ?
- 127.- Si quhet vendi ku mbahen armët ?
- 128.- Ç'gradë mund të ketë një graduat ?
- 129.- Po të doni me dalë nga Presidio-ja, a keni nevojë për lejekalim ?
- 130.- Ku i keni bërë stërvitjet e para ushtarake ?
- 131.- Çka mbajmë zakonisht në një matara ?
- 132.- Me çfarë aparati merren vesh njësit e ndryshme t'ushtrisë ?
- 133.- A dini me gradue një mortajë ?
- 134.- A keni ndonjë shok që gjatë luftës ka qenë në front ?
- 135.- Sa graduatë ka gjithësejt në kursin e gjuhës shqipe ?
- 136.- A keni qëndrue ndonjëherë në formacion ushtarak ?
- 137.- Kur mbaroi lufta e dytë botënore ?
- 138.- Sa kohë ngjasin stërvitjet e para ushtarake ?

- 139.- A keni pá ndonjiherë aeroplana tue fluturue në formacion ?
- 140.- Në rasë mobilizimi të përgjithëshëm, sa divizione mund të ketë Shqipnija ?
- 141.- Kur bje burija, zakonisht ?
- 142.- Sa lloj bombash dore ka ?
- 143.- Kurë ju kanë marrë nën armë ?
- 144.- Në rasë lufte, sa kohë rrin një ushtár në front, zakonisht ?
- 145.- Prej sa pjesësh përbahet një mortajë ?
- 146.- Sa larg mund të shtjerë një revolver ?
- 147.- Sa predha në minut mund të zbrazí një top automatik ?
- 148.- Në ç'vjet filloi lufta e parë botënore ?
- 149.- A marrin pjesë ndër manevra oficerat eprorë ?
- 150.- Ç'gradë duhet të ketë një komandant kompanije ?
- 151.- Ç'lloj armësh kanë ushtarët që shkojnë në patrullë ?
- 152.- Çka mbajmë në një depo, zakonisht ?
- 153.- Çka i duhet busola një ushtari ?
- 154.- Në ç'vjet filloi lufta e Korés ?
- 155.- A keni pá ndonjiherë një top antiajruer ?
- 156.- Thoni emnat e disa armëve automatike ?
- 157.- A dini me përdorue një busolë ?
- 158.- Thoni emnat e disa njisive ushtarake.
- 159.- Sa topa ka një baterí artilerije ?
- 160.- Sa larg mund të shtjerë një pushké ?
- 161.- A keni në këtë klasë ndonji nxânës që bân pjesë n'Artilerí ?

- 162.- Sa nënoficera ka në kursin e gjuhës shqipe ?
- 163.- Gjatë luftës së Korës, a shpalli Amerika mobilizim të përgjithëshëm ?
- 164.- A mund të gradoheni tue qenë në rezervë ?
- 165.- Në rasë lufte, kush dërgohet në front ?
- 166.- A ka ushtria amerikane aspiranta ?
- 167.- Në këtë shkollë, a bëjnë nxënësit rojë ndonjiherë ?
- 168.- Sa topa të vjetër ka në Presidio ?
- 169.- Prej sa togash përbâhet zakonisht një kompaní ?
- 170.- A di çdo ushtár me gradue një top antiajruer ?
- 171.- A keni shti me bazukë ndonjiherë ?
- 172.- Me se merret Ministrija e Mprojtjes Kombëtare ?
- 173.- Po të doni me shkue në Meksik, a keni nevojë për leje-kalim ?
- 174.- A mund të qitet në pension një major me gradën nënkolonel ?
- 175.- Një nënoficer, a mund të jetë njëkohësisht oficer në rezervë ?
- 176.- A keni hý mbrenda një tanksi ndonjiherë ?
- 177.- Kush i ruen depot e armëvet ?
- 178.- A keni bajtë revolver ndonjiherë ?
- 179.- Sa kampe ushtarake ka në Kaliforní ?
- 180.- Ç'gradë ka komandanti i kompanís suej ?
- 181.- A mund të bahet nga një ushtár një mitraloz i rëndë ?
- 182.- Me se merren ushtarët e Xhenjos ?
- 183.- Sa vjetë duhet të rrijë një ushtarë që ka hý vullnetár në Marinë (Aviacion) ?

- 184.- Me se mund të transportohet një top ?
- 185.- Sa mortaja mund të ketë një kompani kambësoriye ?
- 186.- Sa pasagjerë mund të zâjë një aeroplan reaktiv ?
- 187.- Sa lufta botënore ka pasë deri tash ?
- 188.- Për se na nevojitet radioja ?
- 189.- Ç'gradë vjen mbas tetarit ?
- 190.- Cilët quhen graduatë ?
- 191.- Cilat plaçka konsiderohen pajime ?
- 192.- Çka është bajoneta ?
- 193.- A ka ushtria aeroplana ?
- 194.- Ç'moshë duhet të keni për të hy n'ushtëri ?
- 195.- Sa fishekë zë pushka e ré M-15 ?
- 195.- Pse rrijnë ushtarët ndër llogore ?
- 196.- Në luftë, pse mbajnë ushtarët helmetë ?
- 197.- A janë të pajisun të gjithë ushtarët me pushkë granatë-hudhse gjatë një beteje ?
- 198.- A kanë të gjitha armët shinjestër ?
- 199.- Në cilën degë të Fuqivet t'Armatosuna bëjnë pjesë mjetet e korracueme ?
- 200.- Cilët veshin uniformë: civilat apo ushtarakët ?



Military Word List  
(English-Albanian)

Listë Termash Ushtarakë  
(Inglisht-Shqip)

A A gun	top kundërajruer
accountability	intendencë
activate	aktivizoj, vë në veprim
adjutant	adjutant
advance	përparoj, përparim
advance guard	pararojë, rojë e përparueme
aerial photograph	fotografi ajrore
aerial supply	furnizime ajrore, furnizime nga ajri
aggressor	sulmues, agresor
aid man	infermier
aid station	infermeri
aiming point	nishan, shêj
air base	bazë ajrore
airborn	i transportuem me mjete ajrore (me aeroplan a helikopter)
airburst	plasje e nji predhe n'ajr
aircraft carrier	ajrorëmbajtse, aeroplan bajtse
air defense	mprojtje ajrore ase kundër-ajrore
air force	flotë ajrore (usht.), aviation (usht.)
airhead	vend ku furnizimet sillen me anë të mjeteve ajrore
airlift	transportim ajruer
airplane	aeroplan



air raid	bombardim ajruer
air strip	pistë
air support	ndihmë ajrore
air transportation	transportim ajruer
air warning net	sistem radiostacionesh për të dhënë kushtrim antiajruer
all-around defense	mprojtje e përgjithëshme
allocation	kredi për blenje furnizimesh së ndryshme
ammunition supply point	qendër furnizimi të municionit
ammunition train	tren municioni
amphibious	mjete amfibe
antenna	antenë
anti-aircraft gun	top antiajruer
antipersonnel mine	minë kundër njerëzve
antitank defense	mprojtje kundër tanksave
approach march	përparimi e një njisije luftuese kur përleshja e drejt-përdrejtë me anmikun është e paevitueshme
arm and hand signals	sinjale me krahë e me duer
armored	i koracuem
armor-piercing	që shpon koracën
arms	armë
army	armatë; ushtri
army group	grup armatash nën një komandë

arrest	arrestim, rreshtim
arsenal	depo armësh, arsenal
artillery (heavy) (medium) (light)	artilëri (e rëndë) (e mesme) (e lehtë)
assault fire	zjarm për sulm
assault position	pozicion sulmi
assault wire	tel telefoni shumë i hollë që baret në shpinë dhe për- doret prej trupave në front
assembly	mbledhje; sinjali që epet nga borizani për t'u-mbledhë nji- sít e ndryshme sëbashku; grupim njisísh njâna afër tjetrës; grumbullim pjesësh, veglash ase armësh
assembly area	vend mbledhje (për përgatitje)
atomic	atomik
attach	përngjis, atashoj
attack	sulm, mësyemje
attack position	pozicion sulmi
authentication	autenticitet
authenticator	autentikues
automatic	automatik
automatic gun (weapon)	armë automatike
avenues of approach	mënyrë ase rrugë afrimi
axis (evacuation) (communications) (supply)	udhë (zbrazje) (komunikacioni) (furnizimesh)
badge	shêj dallues, distinktiv

bank	breg
barrage	batare
barrel	tytë
barrier	pengesë ase grup pengesash
base of fire	baza e zjarmit a e qitjes
basic load	sasi municioni bazë
battalion	batalion
battery	bateri
battle	betejë, luftim
battleship	anije lufte, luftanije
bazooka (see rocket launcher)	predhë hudhëse, bazukë
beach	plazhë, ranishtë, bregdët
beachhead	kryeurë në bregdët
beachmaster	oficeri i ngarkuem me detyrën e një zbarkimi amfib, komandanti i fuqive të zbarkueme në bregdët
bedding roll	shtresë e mbulesë, cule
belt (terrain)	rryp toke (zak. paralel me frontin)
bench mark	pikë goniometrike
biological agent	mjet biologjik
bivouac	fushim
blackout	errësim
blast area	toka e zharitun përreth grykës së një topi
boat (landing, assault)	barkë, sandall (zbarkimi, mësymje)

bomb	bombë
bombardment	bombardim
bomber	bombardues
bombing	bombardim ajruer
booby trap	grackë (kundër njerzish)
boundary	kufi (vijë që cakton gjâ- nësin dhe thellësin e zonës së veprimit ase të vendit a të sektorëvet të mprojtjes)
bracket (artillery fire)	largësija në mes dy predhash (vendi ku plasin)
branch (arm or service)	degë (ushtarake)
breakthrough	depërtim, çamje e frontit
breech (breechlock)	shul
brevity code	shifër
bridge (floating)	urë (mbi barka)
bridgehead	kryeurë
brigade	brigadë
build-up	formim
bullet	plumb, predhë
bunker	fortifikatë
burial party	njerzit që marrin pjesë në vorrin; personel ushtarak i ngarkuem me mbledhë të vdekunit e të plagosunit mbassi të mbarojë luftimi
burst	plasje, plas
butt	tunë, kondak

by pass	me i dalë armikut anash pa u-ndeshë me 'të
cable	kablo, tërkuzë
caliber	kalibër
call sign	grup germash ase numrash që përdorjnë radiostacionet për t'u-identifikue
camouflage	maskim
campaign	fushatë; luftë me armikun në një vend të caktuem dhe mbrenda datash së caktueme
canalize	me pengue përparimin e armikut me anë pengesash e qitjesh në një zonë sa më të ngushtë
cannibalize	me zâvendësue pjesë maqinash së prishuna prej një maqine tjetër
canister	pjesa e maskës kundër gazevet ku gjinden lëndët kimike për filtrimin e gazevet helmuese; predhë topi që përmban copa të rrumbullakta hekuri
cannon	top
canteen	matara, pagúr
captain	kapiten
capture	zâ, kap, zânie, kapje
carbine	pushkë e shkurtë automatike
cargo	ngarkesë (armë, municion, automjete, ushqime, etj.)
carriage (gun)	pjesa ku mbështetet arma
carrier	kamion ushtarak

cartridge	fishek
cartridge belt	rryp fishekësh
casualties	humbje në njerëz
cavalry	kalorí
ensorship	censurim
certificate	certifikatë
chain of command	oficera eprorë që apin urdhëna
channel	hierarkik
check point	vend kontrollimi, postblok
chemical	kimik
chemical corps	trupa kimikësh
chemical warfare	luftë kimike
chief of staff	kryetari i shtabmadhorís
circuit	qark elektrik
classification	klasifikim
classify	klasifikoj (me konsiderue nji gjâ si të fshehtë)
clear	kontrollim që arma të jetë pa gjâ mbrendë; dërgimi i nji shkrese pa shifra
clearance	shkresë me të cilën i epet leje nji anije, nji njisije etj. me udhëtue nga nji vend në nji tjetër; autorizim për të punue në çashtje sekrete; në rregull
clearing station	infermerí fushore; qendër kontrollimi

clip (cartridge)	krahën fishekësh, karikator
close combat	luftim nga afër
code	shifër
collection point	vend grumbullimi, vend mbledhje të plagosunish, etj.
colonel	kolonel
column	kolonë (formacioni i trupave, i tanksavet e mjetesh tjera lufte njëni mbas tjetrit)
combat command	njisi e madhe taktike (për betejë)
combat outpost	pararojë
combat vehicle	automjet i koracuem ase jo prej nga ushtarët luftojnë
command net	rjetë ndërlidhëse radiotelegrafike (me anë së cilës u epen urdhëna njisive të ndryshme)
command post	komanda e shtabit të një njisije, komandë shtabi
commander	komandant
commissary	dyqan gjânash ushqimi për ushtri
communication(s)	komunikim, ndërlidhje ushtarake, komunikacione
communication(s) center	qendër komunikacionesh, qendër ndërlidhje ushtarake
company	kompani
compass (magnetic)	busolë
complement	kuadri i plotë i një njisije

component	degët e ndryshme që përbëjnë një ushtri
concealment	fshehje, maskim
concentration	përqëndrim
concertina (wire entanglement)	tela me gjemba në formë spirale
contact	kontakt, lidhje ndërmjet njesis
contain (to hold)	përmbaj (ndaloj forcat armike)
contaminated area	zonë e infektueme
control	kontrollim, kontroll; autoriteti që ushtron një komandant mbrenda një njesisje
convoy	karvan(ushtarak ase detár)
coordinated fire plan	plan taktik zjarmi të bashkërenduem
coordinate	bashkërendoj, koordinoj
corporal	rreshter
corps	korparmatë, trup (ushtarak)
corridor (terrain)	koridor, rryp terreni; udhë ajrore që u caktohet aeroplanave miq që mos të gjuhen nga artilerija kundër-ajrore
counterattack	kundërsulm
counterbattery	kundërveprim baterije kundër artilerisë armike
counterreconnaissance	kundërvezhim
countersign	kundërparullë
courier	lajmtár, korier



court-martial	gjq ushtarak
cover	mprojtje, strehim, mprohem
coverage	mprojtje; zonë ushtarake e fotografueme nga ajri; strehim
covering force	trupa mprojtse që shkojnë përpara
crash	rrëzim, shkatërrim
crew-served weapon	armë që për përdorimin e tyre duhet më shumë se një njeri
critique	shohitje veprimesh ushtarake për t'evitue gabime
crossfire	kryqzim zjarmi a qitjesh
cruiser	kryqzuer
deadline (suspense date)	afat, mbarim afati, me nxjerrë jashtë shërbimi për ndreqje
dead space (area not covered by fire)	zonë mbrenda rrezes së një arme që nuk mund të qëllohet për arsye të ndryshme
debarkation	zbarkim
deception	mashttrim, diversion
declassify	mos me e konsiderue më një gjë si të fshehtë
decode	deshifroj
decontaminate	dezinfektoj
defend	mproj
defense	mprojtje
defensive position	pozicion mprojtje

defilade	pengesa natyrale për mprojtje
delaying action	veprim për të vonue përparimin e anmikut
demilitarization	çmilitarizim
demobilization	çmobilizim; me nxjerrë jashtë përdorimi armë atj. që të mos përdoren nga anmiku
demolition	rrenim, shkatrrim
deploy	me zgjânue frontin
depot	depo; qendër zâvendsimi ushtarësh
depth	thellësi (fronti, llogorje)
depth charge	bomba ase eksploziva tjerë që përdoren për plasje n'ujë
desert	dezertim, dezertoj
detached	jo i caktuem me ndonji detyrë; njisi që shërben në një njisi tjetër por nuk është në kuadrin e saj; i damë
detachment	detashment
discipline	disiplinë
disengage	ndërpres luftimin
disperse	me shpërdá
displace	me ndërrue pozicion (në luftim e sipër)
distribution	shpërndamje trupash, damje trupash
division	divizion
draw	luginë, greminë, humnerë

drop zone	vendi ku hudhen parashuti- stat ase furnizimet e ma- terialet
dry storage	magazinë, depo e mbulueme nga të gjitha anët
dud	predhë që s'ka plasë
dugout	llogore nën dhé, strehim
dump (supply)	depo e përkohëshme furnizi- mesh
echelon	mënyra e të renduemit të trupave në front; shkallë- zimi i njisivet ushtarake; nivel, shkallë, rang
element	element, pjesë njisije
elevation	naltësi, kandi i qitjes
embark	ngarkohem në një anije
emblem	dekoratë, nishan; stemë
embrasure	frangji, mazgall
emplacement	vend i përgatitun për topa të rëndë
encirclement	rrethim, të rrethuemit
encode	shifroj, shkruaj me shifra, shifrar
enemy	anmik
enfilade	zjarm për të përfshi gjatë- sin e frontit anmik
engagement	përleshje në mes dy forcash anmike, betejë
engineer (combat)	xhenjo, ushtár i xhenjos
enlist	hýj n'ushtri vullnetarisht

entrench (intrench)	me bâ llogore, me pajisë me llogore, me fortifikue
entruck	me ngarkue ushtarë në kamion
envelop	me mësy anmikun anash e nji- kohësisht edhe përballë
envelopment	sulm kundër anmikut anash e njikohësisht edhe përballë
equipment	pajisje e furnizime
escort	rojë; rojë nderi; njisi mprojtse
estimate of the situation	shqyrtim i gjendjes dhe i të gjitha problemeve ush- tarake
executive officer	oficer ekzekutiv
exploitation	shfrytzim, përfitim
explosive	eksploziv
exposed	i pamprojtun
fatigue (labor detail)	ushtarë që bëjnë punë krahu (jo ushtarake)
feint	sulm jo i vërtetë, sulm për të mashtruar anmikun
field artillery	artilëri fushore
field of fire	vend qitjesh
field telegraph	telegraf fushuer
field telephone	telefon fushuer
field wire	tel telefoni i butë
fighter (aviation)	aeroplan luftues
fighter cover	aeroplan luftues-mprojtës

final protective fire	zjarm i përqëndruem afër nji pozicioni mprojtës
fire adjustment	rregullim qitje, të rregu- lluemit e qitjeve
fire and maneuver	shtimje e manovrim, metodë mësyemje me elemente të mprojtuna nga zjarmi i ele- mentevet tjera
fire control	pregatitje qitjesh; të pasu- nit nën kontroll qitjet
fire discipline	zotsí e disiplinë e persone- lit ushtarak në qitje, disi- plinë në qitje
fire distribution	qitje efektive
fire plan	plan taktik qitjesh
fire superiority	superioritet në qitje
first aid	mjekim provizor (para se të dërgohet ushtaraku në spital)
first sergeant	kapter i klasës së parë
flame thrower	flakëhuhdhëse
flank (right and left)	anë, krah (i djathtë dhe i majtë)
flare	fishekzár për sinjale ushta- rake, raketë
fleet	flotë, flotë detare
flexibility	lehtësí në lëvizje
flight	fluturim, udhëtim me aero- plan
follow up	mos me i u-dá anmikut në tërheqje; me hetue sasín e furnizimevet

formation	formacion
fortification	fortifikim, fortifikatë
fortify	me fortifikim
forward observer	vëzhgues që rri përpara
foxhole	gropë (në të cilën mund të rrijë një ushtar)
frequency	frekuencë, vibracion
front	front, ballë lufte
frontal attack	sulm frontal
fuze	sigurecë, fitil
garrison	garnizon
gas (chemical)	gaz (kimik)
gas mask	maskë kundër gazit
general officer	gjeneral
general outpost	pararojë e përgjithëshme
graves registration	organizatë ushtarake që merret me identifikimin e të vdekurvet dhe me mirëmbajtjen e vorrezave
grazing fire	qitje ku predhat nuk shkojnë më në alt se gjatësija e njeriut me qëllim që të paralizohen lëvizjet e armikut
grenade (hand) (rifle)	granatë dore granatë që hudhet me pushkë
grid line	koordinatë, vijë vertikale ase horizontale mbi një hartë
group	grup; njësi administrative e taktike e përbërë prej dy ose më shumë batalionesh;

guard	rojë
guerilla	guerilje, qetë
gun	top, armë zjarrmi
gunner	artiljer, topçi
gun tube	grykë topi, tyta e topit
handset	telefon ushtarak
harassing fire	qitje kundër anmikut për mos t'a lënë të qetë, qitje jo intensive
hasty defense	mprojtje e organizueme për ngut në luftim e sipër
headquarters	shtab, komandë
headset (headphones)	kufje e mikrofon që vëhen në krye
hedghog	pengesë trekambëshe me tela me gjemba (që mund të baret)
helicopter	helikopter
helmet	helmetë
high explosive (HE artillery term)	eksploziv i fuqishëm
holding attack	sulm me qëllim me e mbajtë anmikun në pozicionet që ka
hospital	spital
howitzer	lloj topi (howitzer)
icing (conditions)	e ngrime, ka akull, akull
identification	identifikim
immobilize	me ngujue, me ndalue
inactivate	me shpirtë

incendiary (bomb)	bombë ndezëse, bombë djegëse
individual weapons	armë vetiake
infantry	kambësori
infiltrate	me depërtue, me u-futë
initial point	pikënisje; pikë bashkimi; objektiv
inspection	inspektim
installation	qendër ushtarake, bazë ushtarake (me kazerma, spitale, etj.)
insubordination	mosbindje urdhëni epruer
intelligence	mbledhje informatash, studimi i informatave të mbledhura për sa i takon zonave të anmike tue përfshirë kohën, terrenin, etj.
interception	luftim kundër anmikut për t'a pengue e ndaluar në kryemjen e misionit të tij
intercept station	radiostacion që ndigjon radion e anmikut për të mbledhë informata
interdict	me pengue anmikun me artileri ase me mjete kimike që të kalojë nëpër një zonë a rrugë
interference	ndërrhymje; trazim që i bëhet një radiostacioni
in the clear (uncoded)	jo e shifrueme, jo me shifra
joint operations	operacione të përbashkëta (zakonisht nga ushtria dhe marina)
jump off	të dalurit nga llogoret për të sulmuar, largimi nga vija e frontit për në sulm, fillimi i një sulmi



landing force	trupa zbarkuese
lanyard	litár i fortë me ganxhe për të zbrazë disa lloj topash
launcher	vegël e posaçme (lloj pushke) për të hudhë granata e raketa
liaison	ndërlidhës, ndërlidhje
lieutenant	toger
lieutenant colonel	nënkolonel
limiting points	pika e mbarimit dhe e fillimit të përgjegjësís së dy njësive
line of departure	pikënisje, vija e frontit prej nga fillon sulmi
listening post	vend i fshehët vëzhgimi prej nga njoftohen veprimet e anmikut
listening silence	nji kohë e caktueme kur radioja përdoret vetëm për të ndigjue
litter	vig, shkalc
log (record of events, journal)	ditár
logistics	logjistikë, intendencë
lot (specific group)	numri ase emni që u epet materialevet të ndryshme
machine gun (light) (heavy)	mitraloz (i lehtë) (i rëndë)
main attack	mësyemje kryesore
main body	trupa bazë
main line of resistance (M.L.R.)	vija kryesore e qëndresës

main supply road	rrugë e veçantë për të furnizue një njësi; rrugë kryesore e furnizimeve
maintenance	mirëmbajtje
major	major
maneuver	manevër
manning table	kuadër personeli dhe detyrat e secilit
map	hartë, paraqitje grafike në plane e harta
march	marshim
marching fire	shtimje në marshim e sipër (tue sulmues)
martial law	shtettrrethim
mass	përqëndrim trupash luftuese dhe zjarmi
material	material (ushtarak)
mechanized	i mekanizuem
medal	dekoratë, medalje
medical corps	trupit mjeksues, trupa shëndet-sore
message	lajm, komunikim, kumtim
message center	qendër marrëse e shpërdase lajmesh e njoftimesh
messenger	lajmtar, korier
microphone	mikrofon
military	ushtarak
military crest (terrain)	kreshtë, kurriz mali
military mission	mision ushtarak

military police	polici ushtarake
mine (antitank) (antipersonnel) (naval)	minë (anti-tanks) (kundër njerzish) (uji)
mine field	fushë e minueme
misbehavior	trathiti, mungesë trimnije
mobile defense	manovrim në mprojtje
mobilization	mobilizim
monitor	radiondigjues (për të mble- dhë sidomos lajme nga anmiku; kontrollues lajmesh që dërgo- hen me çdo mjet)
morning report	raport i mëngjesit, raport i përditshëm ku tregohet: fuqija e njisís, gjendja e saj, sa prezent, sa me leje, sa të sëmundë, etj.
mortar	mortajë
motor pool	autopark
munitions	munition
mutual support	ndihmë reciproke
napalm	napalm; bombë djegëse (napalm është landa djegëse që është në bombë:benzinë e xhelatinë. Huhet nga aero- plani sidomos mbi trupa)
navigator	ai që tregon udhën në det ase n'ajr
navy	marinë
net	rjetë, rjetë radiostacionesh
neutralize	me neutralizue
noncommissioned officer	nënoficer

nurse	infermiere, infermier
objective	objektiv
oblique	i pjerrët
observation post (O.P.)	vend vëzhgimi
occupy	me pushtue me zaptue
offensive	ofensivë
officer	oficer
operations map	hartë operacionesh, hartë ushtarake
ordnance	armë dhe material ushtarak; dega e ushtrisë që merret me mirëmbajtjen e armëve
organization	njisi ushtarake, kuadri i një njisije
outflank	me i marrë krahët anmikut
outpost	pararojë
outpost line of resistance (O.P.L.R.)	vija e qëndresës së pararojës
overhead fire	zjarr përmbi kokat e trupave
overlay	skicë në letër të tejshme; skemë
pack	pajisjet që bënë një ushtarak në shpinë; barra e kafshëve
panel	shëja që përdoren në front për t'u treguar aeroplanave miq ku fillon fronti; copa të mëdhaja pëlhure të lyeme me një mjet kimik që shëndritet
parachute	parashutë

parapet	grumbull dheu për mprojtje përpara llogorevet
pass (terrain)	qafë mali, grykë mali
patrol	patrullë
penetration	depërtim
perimeter	perimetër
phase line	vend ndalimi trupash për riorganizim
photo map	hartë fotografike, riprodhimi i një fotografie të marrun nga ajri
pillbox	fortifikatë betoni (për mitraloza, armë anti-tanks etj.)
pilot	pilot
pipeline	tubacion; udhë nëpër të cilën kalon personeli ushtarak ase materiali ushtarak nga baza në vendin e përdorimit
pistol	revolver
platoon	togë
plunging fire	predhë që bie në tokë tue plasë në një kand të gjënë
point	pikë orientimi; patrullë që shkon përpara; maja e një predhe; me marrë shëj; pikë
pontoon	trap, barka e lundra mbi të cilat mbështetet një urë provizore
port	skele, port, limâ; frangji në një fortifikatë
position	pozicion

powder	barut
preventive maintenance	riparim dhe mirëmbajtje e automjeteve, armëve etj.
prime mover	automjet për të tërhjekë një top, etj.
primer	çdo mjet që përdoret për të ndezë eksplozivin që vë në lëvizje predhën
priority	të vûmit nërradhë të parë të çdo gjâje me rândësi
prisoner (of war)	rob lufte
private	ushtár
private first class	tetár
property	pronë (ndërtesa, tokë, etj.)
protective clothing	rrobe të posaçme kundër gazeve etj.
provost marshall	komandanti i policís ushtarakë
pursuit	ndjekje, me ndjekë anmikun në tërheqje
pyrotechnics	fishekzár, raketë
quadrant	kuadrant, raportor, instrument gradimi për topa
quartermaster	oficer (i naltë) intendence
radar	radar
radio	radio
radio navigation	të gjetunit e drejtimit për det ase për ajr me anë të radios
radio net	rjetë radiostacionesh

radio silence	për t'a mbajtë sekret urdhë- nin e sulmit radiot nuk për- doren veçse pak minuta para se të fillojë mësymja
railhead	vend i posaçëm në një hekur- udhë ku shkarkohen dhe shpër- dahen furnizimet
rallying point	vend mbledhje i një njisisje për t'u riorganizue mbas një beteje a luftimi
range	largësi; rreze; largësija në mes një arme dhe objektivit; largësija e objektivit
range finder	telemetër
rank	gradë
rate of fire	sasija e të shtimevet në një minut
rating	specialist ushtarak (pilot, etj.)
rations	racione
rear	mbrapavijë
rear echelon	pjesa e ushtrisë që rri në mbrapavijat e cila administron dhe furnizon ushtrinë
rear guard	mbraparojë
receiver (radio)	radiomarrëse
reception	qendër ushtarake që i cakton njësin një ushtari i ep paji- sjet etj.
recoilless rifle	lloj pushke që nuk zbrapet kur zbrazet, armë që nuk zbrapet kur zbrazet
reconnaissance	vëzhgim

recruit	rekrut
redeployment	transferim administrativ njisish prej nji vendi në nji tjetër
reference point	pikë konturore, shêj a pikë drejtimi e lehtë me u-gjetë në teren
regiment	regjiment
regimental combat team	skuadër a grup luftimi të nji regjimenti
reinforce	me rforcue
relay	me bâ gati topin për të shti përsëri; me shëndrrue, shndërrim
relief	reliev; largim nga detyra; zâvendësim; zâvendësimi i nji njisije me nji tjetër
reorganize	me riorganizue
replacement	zâvendësim
requisition	kërkesë (për personel a material)
reserve	rezervë
retire	me u-tërhjekë; me dalë në pension
retreat	tërhjekje(e detyrueshme)
retrograde movement	tërhjekje taktike ase e detyrueshme e nji komande
reverse slope	ana tjetër e shpatit
ridge (terrain)	kreshtë mali
rifle	pushkë
rifleman	pushkatar



river line	bregu i lumit nga ana e mprojtsit
road block	barikadë, pengesë në rrugë
road net	rjetë rrugësh
rocket	roketë, misil, bombë me reaksion
rocket launcher	roketë hudhse, misil hudhse, hudhse bombash me reaksion
roll call	apel, thirrje emnash (thirrja emën për emën)
route	rrugë, hikja e një ushtrie së thyeme në shregullim; me vû anmikun në të hikun
runner	lajmtár kambauer
sabotage	sabotim
saddle (terrain)	kurriz që bashkon dy maje malesh má të nalta
sailor	detár, marinár
salient	pjesa e zonës së betejës që shtrihet drejt për drejtë kundrejt frontit
salvage	automjete etj. të prishuna pjesët e të cilave mund të përdoren; grumbullim veglash ase maqinash të nxjerruna jashtë përdorimi
scabbard	këllef arme, millë
scar	mbresë, vrazë
scout	kallauz, njeri që njef tere- nin anmik, njeri që vete në mbrapavijat anmike për të mbledhë informata

screen	maskim; tansija e veprimevet që bâhen për t'i fshehë armikut çdo gjâ
secondary position	pozicion i dytë
secret	sekret
section	sekcion
sector	sektor
security	sigurim, masë sigurimi
self-propelled	vetëlëvizës, që shkon vetë
sentry post	vendi i rojës
sergeant	kapter
shell	predhë, gjyle topi
shelter	strehim (për mprojtje)
shock action	veprim i rrufeshëm në sulm
shore	breg deti, breg liqëni, breg lumi
shrapnel	shkrapnel, shrapnel
signal	sinjal
signal operation instruction (SOI)	udhëzime mbi përdorimin e sinjalevet
skirmish	luftim i vogël, luftë patrollash
slit trench	llogore nën dhë që ka pothuej formën e një kanddrejti
small arms	armë të lehta
smoke	tym, tym si mjet maskimi
sniper	snajper, ushtár që shtie nga një vend i fshehët

soldier	ushtár; ushtarak
spearhead	trupat që udhëheqin një sulm
squad	skuadër
squadron	njisi mesatare në flotën ajrore; njisi taktike e administrative në kalorí
staff	shtab
staging area	vend kontrollimi dhe furnizimi trupash afër një limani para se të nisen
strafe	me mitralue me aeroplan nga afër (trupa e objektiva në tokë e anije në det)
submachine gun	pushkë e shkurtë automatike, mitraloz dore
submarine	nëndetse
sump	gjiriz; gropë kullimi ujnash së ndytë
supply discipline	disiplinë që ushtrohet në të kursyemit e furnizimevet
supply point	vend furnizimesh, depo, pikë furnizimesh
support	ndihmë ase mprojtje (që një njisi i ep një tjetre)
sustained defense	difensivë a mprojtje që synon me ndalue sulmin e armikut në vijën e mprojtjes
tactical	taktik
tactical air support	ndihmë taktike ajrore (që u epet fuqivet toksore)
tactics	taktikë

tank	tanks
tank dozer	tanks-bulldozër, tanks i rregulltë që ka një paftë hekuri si thikë përpara për të largue dhe
target	nishan, shêj, objektiv ase grup objektivash; zonë ku drejtohen të shtimet
task force	bashkim i përkohëshëm njisish nën një komandë për kryemjen e një misioni të veçantë
teletype	maquinë telegrafike që shkruen automatikisht
terrain	teren
thrust line	dy pika të caktueme në një hartë e të lidhuna me një vijë (përdoret si referencë për të dhënë pozicione tjera)
time fuze	sigurecë me sahat
tracer (ammunition)	predhë-raketë, predhë me dritë
trains (combat, field)	trena (fushorë,luftimi)
transmitter	radiodhânëse, radiotransmetuese, aparat transmetues
transportation	transportim
treadway	binar hekurudhe mbi disa lloj urash
trench	llogore; hendek për mproj-tje
trip-wire	tel i ngritun pak përmbi dhe me qëllim që të marrin më thue trupat armike
troops	trupa (njisí administrative e taktike ushtarake)

truce	armëpushim
truck	kamion
truckhead	vend ku shkarkohen furnizimet prej kamionave (dhe ngarkohen ndër trena)
turning movement	lëvizje për të dalë mbrapa anmikut (me qëllim për të sulmue një objektiv tjetër që gjindet thellë mbrapa frontit anmik pa ndeshje të mëdhaja me 'tê)
uniform	uniformë
unit	njisí
urgent	urgjent
veterinary	veterinari
warning net	rjetë mjetesh që lajmon lëvizjet e anmikut dhe të aeroplanave e anijeve të tij (radio, radar, etj.)
warrant officer	degë e veçantë oficerash teknike të fuqive t'armatosuna (kanë vetëm katër grada)
water point	vend i posaçëm për të nxjerrë ujë
weapons	armë
windage	ndikimi i erës (që i ndërron drejtimin predhës)
withdraw	me u tërhjekë, tërhjekje, me u-tërheqë, tërheqje
wound	me plague, plagë

zero

të rregulluemit e shinjes-  
trës në mënyrë që të qëllo-  
het shêji mu në mes tue marrë  
parasÿsh naltësín dhe ndiki-  
min e erës, objektivi në  
shinjestër

zone

zonë